



Në mbështetje të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në pajtim me Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall konkurs të jashtëm për pozitën:

**ZYRTAR PËR PAGESA I LISTAVE TË 20%  
(1 Pozitë)**

**Numri i Referencës:** 31 /2019  
**Lloji i Pozitës:** Karrierës  
**Orari:** I plotë  
**Kohëzgjatja:** Pa afat  
**Grada - Hapi:** 5-4  
**Njësia:** Komisioni i Listave të 20%  
**Vendi i Punës:** Zyra Qendrore  
**Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë :** Kryesues i Komisionit të Listave të 20%

**QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I POZITËS**

Zyrtari për Pagesa i Listave të 20% luan një rol kyç dhe funksional në ekzekutimin e politikave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për transformim ekonomik në këtë fushë. Ka përgjegjësi të përgatit planet kohore, kalkulimin, kërkesat dhe shpërndarjen e 20% nga çmimi i shitjes së asetëve të Ndërmarrjeve shoqërore (NSH) për punëtorët e NSH-ve. Zyrtari për Pagesa i Listave të 20% i përgjigjet Kryesuesit të Komisionit të Listave të 20%

**Fushëveprimi për këtë pozitë është:**

- ✓ Koordinimi me Zyrat Rajonale dhe Departamentet tjera në Zyra Qendrore;
- ✓ Kalkulimi dhe shpërndarja e fondeve të 20%.

**DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË**

**Detyrat e Përgjithshme**

- Në koordinim me Departamentin e Financave dhe Buxhetit e bën përgatitjen e planeve për shpërndarje të 20%-it. Është përgjegjës që të bëjë kalkulimin dhe kërkesat për shpërndarjen e pjesshme të fondeve të 20% për listat e punëtorëve të NSH-ve.;
- Është përgjegjës që të bëjë kalkulimin dhe kërkesat për shpërndarjen e 20% për punëtorët e kualifikueshëm për asetet e të njëjtës NSH të shitur në faza të më vonshme (Valët e privatizimit dhe shitjet përmes Likuidimit);
- Përgatitjen e historikut të NSH-ve me kërkesë të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve;
- Plotësimin dhe azhurnimin e bazës së të dhënave të Komisionit të Listave të 20% të Punëtorëve si dhe mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave si dhe azhurnimin e Sistemit të Menaxhimit të Aseteve;
- Dizajnon, menaxhon, korigjon dhe kontrollon bazën e të dhënave për listat e punëtorëve dhe pagesat e 20%;
- Përcjell afatet e kontratave me gazeta për publikime të listave të punëtorëve nga Komisioni i Listave të 20% të Punëtorëve;
- Është përgjegjës për planifikimin e linjës buxhetore që shërben për publikimin e listave të punëtorëve;
- Detyrat dhe përgjegjësit tjera shtesë sipas kërkesës së kryesuesit të Komisionit të Listave të 20% dhe Drejtorit të Komisioneve profesionale të AKP-së;



## PËRGADITJET PROFESIONALE / KUALIFIKIMET

- Diplomë Universitare në ekonomi, financa, kontabilitet, menaxhment apo administrim biznesi;
- Së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën relevante;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme organizative dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve të mëposhtme softuerike të pakos MS;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ ose serbe në të folur dhe shkruar. Gjuha angleze e preferuar.

Formularin për aplikim mund ta gjeni në:

[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Për aplikim, të gjithë kandidatët duhet t'i bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

Formularin e plotësuar dhe të firmosur;  
Letrën përcjellëse/motivuese;  
Dëshmi mbi përgatitjen profesionale;  
Dëshmi mbi përvojën e punës;  
Dy letër rekomandime;  
Dokumentin e identifikimit;  
Certifikatën që nuk jeni nën hetime.

Formularin për aplikim së bashku me dokumentet përcjellëse i dërgoni në adresën elektronike:

[rekrutimi@pak-ks.org](mailto:rekrutimi@pak-ks.org)

Titulli i e-mailit tuaj duhet të përmbajë pozitën për të cilën ju aplikoni.

**Data e fundit për aplikim është: 7 SHTATOR 2019 ora 16:00**

**Dokumentet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar do të refuzohet.**

“ Agjencia Kosovare e Privatizimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komuniteti jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Ne i falënderojmë të gjithë kandidatët për aplikim, por vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen.